

URDHËR
Nr.69, datë 17.7.2007

**PËR PRODHIMIN, EMETIMIN, ADMINISTRIMIN DHE SHITJEN E POLICËS KUFITARE
TË SIGURIMIT**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe nr.295, datë 15.9.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë“, miratuar me ndryshime me ligjin nr.7641, datë 1.12.1992, me qëllim ruajtjen e forcimin e stabilitetit të tregut në produktin e sigurimeve kufitare të mjeteve motorike dhe për të mos cenuar konkurrencën në shërbimin e shitjes së policave të sigurimit për mjetet motorike me targë regjistrimi të huaj, me rekomandim të Autoritetit të Konkurrencës,

URDHËROJ:

1. Prodhimi, emetimi dhe administrimi i policave kufitare të sigurimit të bëhet nga Byroja Shqiptare e Sigurimit.

2. Forma e policës kufitare të sigurimit të jetë në përputhje me urdhrin datë 5.7.2002 të Ministrit të Financave “Për emetimin e policave të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, i ndryshuar.

3. Shoqëritë e Sigurimit, të shesin policat kufitare të sigurimit në sportelet e veta apo nëpërmjet agjentëve të licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, që veprojnë në pikat e kalimit kufitar të Shqipërisë dhe në pika të tjera të brendshme, njësoj si policat e sigurimit TPL e brendshme.

4. Shitja e policave kufitare të sigurimit të bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara për plotësimin korrekt të tyre dhe duke respektuar primet e pastra dhe shpenzimet administrative minimale të përcaktuara nga Ministri i Financave në zbatim të ligjit.

5. Shitja e policave kufitare të sigurimit të realizohet në mënyrë on-line.

6. Shoqëritë e sigurimit të përballojnë pagesën e dëmeve të shkaktuara në Shqipëri nga mjetet motorike të huaja të siguruara prej tyre me polica kufitare sigurimi.

7. Prodhimi, emetimi, administrimi dhe shitja e policave kufitare të sigurimit është objekt i mbikëqyrjes nga ana e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

8. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, të gjitha policat kufitare të sigurimit gjendje të paplotësuara t’i kthehen Byrosë Shqiptare të Sigurimit, me inventar të rregullt.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe shoqëritë e sigurimit që do të ushtrojnë veprimtarinë e sigurimit të mjeteve motorike me targa të huaja regjistrimi.

10. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, shfuqizohet urdhri nr.14, datë 6.5.2005 i Ministrit të Financave “Mbi shitjen dhe administrimin e policës kufitare të sigurimit nga Byroja Shqiptare e Sigurimit”, me ndryshimet, si dhe çdo urdhër tjetër i nxjerrë në zbatim të tij.

11. Ky urdhër botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 tetor 2007.

MINISTRI I FINANCIVE
Ridvan Bode